

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 821 / 20
 Datë/Datum. 28.10.20

PRISHTINË - PRIŠTINA



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
 TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
 PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Lavdim Fejza eks.Shqyrtues / Teknik 	Data e autorizimit të ekspertit 26.10.2020	Data e dorëzimit të raportit 28.10.2020	Nr. i lëndës: 821/20
---	---	--	-------------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.10.2020, Operatori Ekonomik "Ex Project"shpk -Ferizaj, ka parashtruar ankesë me nr:821/20, kundër njoftimit për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me eksploziv" me nr.prok: 1299712998-20-4146-1-1-1 iniciuar nga Trepça SH.A

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës, LOT1 dhe LOT 2, blerje, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 470.000,00€.

Vlera e parashikuar e kontratës per LOT 1 : 390.000,00€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092,

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE-OE "Ex Project"shpk -Ferizaj,

Me rastin e njoftimit si OE i pa sukseshëm dhe anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit për llot 1 AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe atë të neneve si më poshtë:

Neni 1,
 Neni 6,
 Neni 7,
 Neni 9,
 Nenin 38,
 Neni 56.3,
 Neni 59,
 Nenin 62,
 Nenin 108A,
 Neni 8,44 dhe 56 të RUOPP

Ashtu siq u cekë më lartë nga AK përmes kërkesë për ri-shqyrtim kemi kërkuar që në pajtim me dispozitat e nenit 108A të evitohen gabimet që komisioni vlerësues i ka bërë me arstin e vlerësimit.ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve,është e pa kuptueshme si ka mundësi që AK me fajin e vetë dëshiron të anulon këtë aktivitet të prokurimit edhe pse e din mirë që vlera e parashikueshme për kontratë nuk i përmbush kërkesat pas ndryshimeve në sasi tek paramasa dhe parallogait.

E njoftojm Organin Shqyrtues të Prokurimit se AK-Trepqa Shoqëri Aksionare me rastin e zhvillimit të këtij aktivitetit të prokuimit gjatë përgaditjes së DTpërkatesish paramasat dhe parallogari ka dështuar në kërkesat e nevojshme për sasi tek pozicioni 2 dhe 5.

Pas pranimit të DT konfor LPP kemi kërkuar sqarime duke parshtruar pyetje lidhur me këtë qështje dhe atë me dt. 19.08.2020.

Pyetja ka qenë kjo:

“Eshte nje disbalanc te kerkesa per Nonel LP me Nonel Konektor dhe Lidhesa. Besoj qe keni gabuar sepse sasia e kerkuar per Nonei LP eshte shume e vogel ne krahasim me Konektor dhe Lidhesa!!

Sasia e kerkuar e None! LP, qe eshte ne dosje, eshte sasi qe normalisht kerkohet me nje porosi dhe eshte sasi qe normalisht ne kushte normale harxhohet per 1-2 muaj!

Ju kisha lutper sqarim, nese e keni gabu sasine apo kjo eshte sasia reale e kerkuar!??”

Përgjigje nga Ak ka qenë kjo:

“I/E nderuar sipas pergjigjes nga njësia e kërkesës na bëjnë me dije që kërkesa është në rregull.

Ju lutem referoju specifikimit në dosjen e tenderit.”

Provëftetër komunikimi me AK- Trepqa Shoqëri Aksionare.

Lidhur me këtë ne kemi kërkuar përgjigje dhe sqarim nga Drejtori me qëllim që të evitohen gabimet e lartëcekura dhe që projekti të jetë i kompletuar dhe funksional sipas nevojave të AK.

Pas vrejtjeve të parashtruara tek Drejtori kemi marr DT të korigjura në paramasat 2 dhe 5 ku vrehet dallimi i dukshëm me të parën është fjalapër DT.

Provë: dy paramasat e DT

Ne kemi ofertuar si OE që kemi inters juridik dhe material për dy llotet ku në llotin1 kemi ofertën e përgjegjshme dhe me qmim më të lirë në pajtim me kriterin e dhënjes së kontratës.

Me rastine vlerësimit AK llotin 1 e anulon ndërsa për llotin 2 rekomandon OE e caktuar për dhënie të kontratës.

Arsyetimi i AKpër anulim është: "Trepça SH.A anulon aktivitetin e prokurimit Furnizim me eksploziv (për Minieren e Stantërgut) LOT 1 pasi dy ofertat e pranuara tejkalojnë çmimin e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit".

F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK

AK-Trepça Shoqëri Aksionare me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit: "Furnizim me eksploziv (LOT I)", numri i aktivitetit të prokurimit: 12997 12998-20-4146-1-1-1, nr i brendshëm ST KHA 20 073/074 111 ka bërë Vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-se Nesi OE nuk pajtohem me këtë arsyetim të AK sepse është e evidente që është bërë vërtetim i gabuar i gjendjes faktike me rastin e vlersimit të ofertave dhe krahasimin e tyre sipas kërkesave dhe nevojave të AK.

Kjo vrehet edhe për faktin se me rastin e përgaditjes së DT edhe për kundër vërtetjes sonë AK nuk ka ndërmarr veprime që të bëjë përmirsimet në pozicionet e caktuara dhe e cila ka ndodh vetëm pas sqarimeve që kemi bërë me drejtorin përgjegjës, AK pas ndryshimeve nuk ka siguruar fonde të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit të përmbyllet me sukses për sqarim ju përkujtojmë se buxheti që AK i ka planifikuar për lot I ka qenë 390.000.00 euro kurse për lot 2 ka qenë 80.000.00, edhe përkundër rritjes së sasive në dy pozicionet AK fare nuk ka rritur buxhetin përkatsish nuk ka siguruar fonde të mjaftueshme për të përfunduar me sukses këtë aktivitet të prokurimit apo të na njoftoj lidhur me këtë.

Është e evidente se dy ofertat e kanë tejkaluar vlerën e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit sepse nga ana e AK nuk është rritur vlera e parashikuar pas rritjes së sasive që nënkupton se me rastin e rritjes së sasive duhet të rritet edhe bugjeti dhe fondet për atë sa ka ndryshim në sasi.

Është për të ardhur keq gadishmëria e AK për të anuluar këtë aktivitet të prokurimit kur AK është përcaktuar për një kontratë kornizë kur dihet mirë që edhe sasi dhe vlera janë indikative, edhe përkundër që me fajin e AK janë bërë gabimet në sasi.

Nëse bazohemi në dispozitat e nenit 38 të LPP mbi kontratat publike kornizë dhe nenit 56 të RUOPP tek kontratat kornizë nëse kemi çmimin për njësi ajo do të aplikohet dhe nuk është obligative që sasi dhe vlera të realizohen 100% të kontratës sepse neni 56.10 i RUOPP e qartëson se devijimet mund të jenë +/- 30% shihë nenin 56.10: "56.10

Sasia

e

parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e

kontratës si një prag apo një tavan dhe dotë lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes

së lejuar.

Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/mittus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht".

Andaj në rastin konkret kemi të bëjmë me kontratë kornizë dhe për AK është përgjegjsi e saj të përmbyll aktivitetin e prokurimit për aq fonde sa ka në dispozicion dhe asnjëherë në kontratat kornizë nuk kemi një parashikim të sakt të sasive dhe vlerave,esenciale që kontratat domosdoshmërisht të implementohen në mas prej 70% plus minus 30% prej totalit 100%,te këto kontrata AK ka të drejtë që të kaloj masën 100% pra plus edhe 30%,për këtë aktivitet të prokurimit ka fonde dhe mund të sigurohen në të ardhmen,nuk ka mundësi dhe është jo logjike dhe e pa ligjshme që tëket tejkalim të fondeve të parashikuara në kontratat kornizë sepse në momentin që nuk ka fonde mund të përfundoj kontrata.

KRITERET PËR VLERËSIM

Aneksi 1-Specifikime teknike te detyrueshme.
Çmimi me i lire i ofruara.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni i vleresimit konstaton se kemi dy oferta të përgjegjshme për LOT2 , ndërsa për LOT 1 dy ofertat e pranura kanë tejkeluar çmimin e planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Komisioni i vlersimit rekomandon qe per LOT 2 të shperblehet N.P.P."NITI" SH.P.K., 600248589 me çmimin me të lire të ofruar 76 228,00€.

Ndersa për LOT 1 rekomandon që të anulohet ky akitivitet i prokurimit pasi ofertat e pranuar tejkalojne buxhetin e planifikuar për kete aktivitet të prokurimit.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE -“Ex-Project” shpk -Ferizaj

Përgjigje ne pretendimin 1.

Pretendim kryesore ka te beje me anulimin e aktiviteti te prokurimit “Furnizim me eksploziv” (për Minieren e Stantërgut) LOT 1 pasi dy ofertat e pranuar tejkalojne çmimin e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit”.

Eksperti shqyrtues/ teknik sqarone se autoriteti kontraktues e ka pezulluar kete ativitet te prokurim pasi ofertat e pranuar tejkalojne çmimin e planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit, pasi qe vlera e mjeteve te alokuara per kete aktivitet ka qene për LOT 1 : **390.000,00€**, ndërsa oferta e operatorit ekonomik ankues për LOT1 është **537,195.00€**

Në bazë të LPP-së të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në mase substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit, duhet të anulohet ky aktivitet.

Andaj, pretendimi i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura, eksperti shqyrtues/ teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Ex-Project” shpk -Ferizaj, të aprovohet si e pa bazuar, si dhe rekomandojn që të mbete në fuqi vendimi i AK-se njoftimi për anulim të këtij aktiviteti.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- | | |
|---------------------------|------------------------------|
| - Autoritetit Kontraktues | - KEK |
| - Panelit Shqyrtues | - OSHP-se. |
| - OE ankues | - “Ex-Project” shpk -Ferizaj |